




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



Në bazë të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për procedurat e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë, bazuar në Vendimin 01.Nr.109/2023 të datës 31.7.2023 për themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, Kuvendi i Komunës Rahovec, shpall:



KONKURS PUBLIK

Për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me aftësi të kufizuara

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara do të përbëhet nga 7 anëtarë.

Mandati i anëtarëve të Komitetit është katër (4) - vjeçar, nga themelimi i Komitetit. Anëtarët e zgjedhur nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

Kompetencat:

- Ofrimi i propozimeve për rregullore të ndryshme dhe akte të tjera të brendshme për fushën e aftësisë së kufizuar;
- Koordinimi i politikave, i programeve dhe i proceseve në lidhje me çështjen e aftësive të kufizuara dhe zhvillimi i hulumtimeve në fushën përkatëse;
- Analizojnë çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e tyre;
- Definimi i prioriteteve dhe i masave të nevojshme që duhet të ndërmarra nga Kuvendi i Komunës dhe Shoqëria Civile për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me personat me aftësi të kufizuara në secilin sektor;
- Hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme, apo edhe Kuvendi i Komunës në fushën e personave me aftësi të kufizuara;

- Paraqitja e pikëpamjeve dhe e mendimeve të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës;
- Përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet nga sfera e personave me aftësi të kufizuara, të cilat, në pajtim me dispozitat ligjore, miratohen në Kuvendin e Komunës;
- Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga fusha e personave me aftësi të kufizuar.

Kushtet:

- Të jetë banor i komunës Rahovec;
- Diplomë universitare në lëmin përkatës ose të ngjashëm (e dëshirueshme);
- Të jetë njohës i mirë i fushës së Personave me aftësi të kufizuara;
- Kopja e letërnjoftimit.

Aplikacionet që përbëhen nga kërkesa, CV-në dhe dëshmitë për përvojën tuaj në lëmenjtë e theksuar më lart, duhet t'i dorëzoni në Zyrën e pranimit të KK-së, duke cekur për Sekretarinë e Kuvendit të Komunës Rahovec.

Përzgjedhja e anëtarëve të Komitetit Konsultativ bëhet nga Paneli përzgjedhës i formuar me Vendimin 01.Nr.109/2023 të datës 31.7.2023, nga Kuvendi i Komunës Rahovec.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.

Aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, respektivisht pas datës 17 tetor 2023, nuk do të merren në shqyrtim.

Vërejtje: Dokumentacioni i bashkëngjitur aplikacionit duhet të jetë i fotokopjuar.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni Sekretarinë e Kuvendit të Komunës Rahovec.



Kryesuesi i Kuvendit
Arbër Zenuni